



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

NJOFTIM

Ju lutemi, gjeni më poshtë njoftimin e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, e cila do të zhvillohet ditën e **Enjte datë 30 Maj 2024, ora 16:00**, në sallën e Këshillit Bashkiak.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të nenit 53 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ju përcjell për shqyrtim dhe diskutim, pikat e rendit të ditës, si më poshtë:

- 1. Projektvendim “Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-dihmës ekonomike deri në 6 për qind, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1- 30 prill 2024”.**
- 2. Projektvendim “Për miratimin e bonusit të qirasë të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga zbatimi i projektit të segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja- Bulevardi i Ri, Shkozë””.**
- 3. Projektvendim “Për miratimin e pagesës së qirasë sipas vlerës së tregut të lirë, të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, me qëllim realizimin e projektit “Për zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative Nr. 6, zona “Kombinat”.**
- 4. Projektvendim “Për trajtimin me subvencionin e qirasë të disa familjeve në nevojë, që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë”.**
- 5. Projektvendim “Për dhënien e pëlqimit për përdorimin si pikë bllokimi nga Policia Bashkiake të pasurisë në pronësi të Bashkisë Tiranë me numër 867/4, ndodhur në ZK. 2529”.**
- 6. Projektvendim “Për krijimin e shoqërisë “Teda Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e akteve të themelimit”.**

Ju faleminderit,

Romina Kuko

Kryetare e Këshillit Bashkiak

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

Komisioni i Financave dhe Buxhetit, do të shqyrtojë pikat **1,2,3,4,6** dhe do të mblidhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e **mërkurë, datë 29 maj, ora 11:30**.

Komisioni i Çështjeve Ligjore dhe Drejtësisë Sociale, do të shqyrtojë pikat **5,6** dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, **ditën e mërkurë, datë 29 maj, ora 13:30.**

Komisioni i Planifikimit Urban dhe Strehimit Social, do të shqyrtojë pikat **2,3,4** dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, **ditën e mërkurë, datë 29 maj, ora 16:00.**